



RUBINI KRITIKON SPECIALEN PËR GJYKIMIN E KRERËVE TË UÇK-së: KJO NUK ËSHTË DREJTËSI, AKUZAT JANË TË PABAZA



Ish-ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, James Rubin, në ditën e dytë të dëshmisë së tij në Dhomat e Specializuara në Hagë, është ballafaquar me pyetjet e prokurorisë dhe me disa deklarata

që kishte dhënë më parë rreth këtij procesi gjyqësor dhe aktakuzën ndaj Hashim Thaçit dhe të tjerëve. Ai e quajti të padrejtë mbajtjen për pesë vjet në paraburgim të të akuzuarve, të cilët, sipas tij, u

dorëzuan vullnetarisht. Rubin ka thënë se kjo nuk është drejtësi dhe akuzat janë të pabaza. Ai në dëshminë e tij ka pohuar se nuk kishte kontroll dhe komandë efektive në UÇK

**BARDUANI: RRUGA
DREJT SIGURISË
SË QËNDRUESHME
NË KOSOVË
NUK ËSHTË
USHTARAKE,
POR POLITIKE** F. 7



**SI U PRIT
NË KOSOVË
DËSHMIA E JAMES
RUBINIT NË
MBROJTJE TË
THAÇIT NË HAGË?** F. 3



**RAFUNA: BIZNESET PO PËRBALLEN
ME SFIDA QË S'KANË QENË
ASNJËHERË QË 25 VJET** F. 8

**ZKA-ja: FONDI PËR BURIMET E
RIPËRTËRISHME TË ENERGJISË
NUK U MENAXHUA NË MËNYRË
EFIKASE** F. 8

SPORT



**DUKA: SHOQPËRIA DO TË LUAJË
ME SERBINË NË LESKOVAC,
VENDIMI PËR SYLVINHON
NË VARËSI TË KUALIFIKIMIT** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

HETUESIT E OKB-SË PRETENDOJNË SE IZRAELI KA KRYER GJENOCID NË GAZË

NJU-JORK, 16 SHTATOR - Hetuesit e Kombeve të Bashkuara akuzuan më 16 shtator Izraelin se ka kryer gjenocid në Rripin e Gazës me qëllim të “shkatërrimit të palestinezëve” dhe fajësuan kryeministrin izraelit dhe zyrtarë të tjerë të lartë për nxitje. Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar i Hetimit i OKB-së (COI), i cili nuk vepron në emër të organizatës botërore - konstatoi se “gjenocidi po ndodh në Gaza dhe vazhdon të ndodhë”, tha për agjencinë AFP kryetarja e komisionit, Navi Pillay. “Përgjegjësia bie mbi shtetin e Izraelit”, theksoi ajo, raporton “Radio Evropa e Lirë”. Komisioni, i ngarkuar t’i hetojë shkeljet e të drejtave në territoret palestineze të okupuara, publikoi raportin e tij më të fundit pothuajse dy vjet pas shpërthimit të luftës në Gaza, që nisi pas sulmit vdekjeprurës të Hamasit më 7 tetor 2023 brenda Izraelit. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian e konsiderojnë Hamasin organizatë terroriste. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë në Gaza, që kontrollohet nga Hamasi, mbi 65

mijë persona janë vrarë që nga fillimi i luftës. Kombet e Bashkuara i konsiderojnë këto të dhëna të besueshme. Shumica e banorëve të Gazës janë zhvendosur të paktën një herë, ndërsa shpërnguljet masive vazhdojnë teksa Izraeli shton përpjekjet për ta marrë nën kontroll qytetin e Gazës, ku OKB-ja ka shpallur gjendje urie të plotë. Hetuesit theksuan se që nga tetori 2023 autoritetet dhe forcat izraelite kanë kryer “katër nga pesë veprat e gjenocidit” të përcaktuara në Konventën e vitit 1948 për parandalimin dhe ndëshkimin e gjenocidit. Këto përfshijnë: “vrasjen e anëtarëve të grupit, shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore ose mendore, imponimin e qëllimshëm të kushteve të jetesës që synojnë shkatërrimin fizik të grupit në tërësi ose pjesërisht dhe masat për t’i parandaluar lindjet brenda grupit”. Sipas raportit, deklaratat e hapura të autoriteteve civile dhe ushtarake izraelite, të shoqëruara me modelin e sjelljes së forcave izraelite, “tregojnë se veprat e gjenocidit janë kryer me qëllim të shkatërrimit të



palestinezëve në Rripin e Gazës si grup”. Raporti arrin në përfundimin se presidenti izraelit Isaac Herzog, kryeministri Benjamin Netanyahu dhe ish-ministri i Mbrojtjes, Yoav Gallant, “kanë nxitur kryerjen e gjenocidit” dhe se autoritetet izraelite nuk kanë ndërmarrë masa për t’i ndëshkuar për këtë nxitje. “Përgjegjësia për këto krime monstroze bie mbi autoritetet izraelite në nivelet më të larta”, tha Pillay, ish-gjyqtare nga Afrika e Jugut, që ka udhëhequr më parë tribunalin ndërkombëtar për Ruandën dhe ka qenë shefe e të drejtave të njeriut në OKB. Komisioni nuk ka fuqi gjyqësore,

por raportet e tij mund të shërbejnë si presion diplomatik dhe si bazë për mbledhjen e provave për gjykata. Pillay i tha AFP-së se komisioni po bashkëpunon me prokurorin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare. “Kemi ndarë mijëra informacione me ta”, tha ajo. “Bashkësia ndërkombëtare nuk mund të heshtë për fushatën gjenocidale që Izraeli ka nisur kundër popullit palestinez në Gaza”, deklaroi ajo gjatë paraqitjes së raportit përfundimtar. “Mungesa e veprimit për ta ndaluar këtë përbën bashkëpjesëmarrje”, paralajmëroi ajo. Izraeli që nga fillimi i luftës është

përballur me akuza për gjenocid nga organizata joqeveritare, ekspertë të pavarur të OKB-së, madje edhe në gjykata ndërkombëtare. Autoritetet izraelite i kanë hedhur poshtë fuqishëm këto akuza. Vetë Kombet e Bashkuara nuk e kanë cilësuar situatën në Gaza si gjenocid, ndonëse shefja e ndihmës së organizatës në maj bëri thirrje për veprim të vendosur për ta “parandaluar gjenocidin”, ndërsa javën e kaluar komisionerja e OKB-së për të drejtat e njeriut dënoi “retorikën gjenocidale” të Izraelit. Në janar 2024 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë i urdhëroi Izraelit t’i parandalojë aktet e “gjenocidit” në Gaza. Katër muaj më vonë gjykata lëshoi urdhërarreste për Netanyahu dhe Gallantin për dyshime mbi krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. I pakënaqur me këtë veprim, muajin e kaluar presidenti amerikan Donald Trump vendosi sanksione ndaj dy gjyqtarëve dhe dy prokurorëve të kësaj gjykate, përfshirë ndalimin e hyrjes në ShBA dhe ngrirjen e pasurive të tyre në vend.

ZELENSKY U BËNË THIRRJE VENDEVE EVROPIANE TA ZHVILLOJNË MBROJTJEN AJRORE PAS SULMIT TË FUNDIT RUS

KIEV, 16 SHTATOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u bëri thirrje vendeve evropiane ta nisin krijimin e një “ombrelle mbrojtëse ajrore”, pasi Rusia bombardoi sërish qytetin ukrainas Zaporizhia, duke plagosur të paktën 13 persona, mes tyre dy fëmijë. Në një postim në rrjetet sociale më 16 shtator, Zelensky tha se raketat ruse “goditën qëllimisht për ta terrorizuar popullin tonë”, duke dëmtuar “shumë ndërtesa banimi”. Ai shtoi se që nga fillimi i shtatorit, Moska ka lëshuar mbi 3 500 dronë dhe gati 190 raketa, si dhe mbi 2 500 bomba ajrore, kundër objektivave brenda Ukrainës dhe ka kryer “provokime ndaj partnerëve tanë”. “Ky është ai lloj terrori ajror kundër të cilit Ukraina kërkon mbrojtje të përbashkët - në mënyrë që askush të mos detyrohet të ngrejë me nxitim avionë luftarakë dhe ta ndiejë presionin e Rusisë në kufijtë e tij”, shkroi Zelensky. “Tani është koha ta zbatojmë mbrojtjen e përbashkët të qiellit evropian me një sistem të shumëfishtë mbrojtjeje ajrore. Të gjitha teknologjitë për këtë ekzistojnë tashmë. Ato që nevojiten janë

investimet dhe vendosmëria - veprime të forta dhe vendime nga të gjithë partnerët tanë”. Çështja e neutralizimit të dronëve rusë, të cilët janë shtuar ndjeshëm gjatë më shumë se tre viteve të luftës, ka marrë vëmendje të re pasi mbi një duzinë dronësh rusë depërtuan javën e kaluar në Poloni, ndërsa një tjetër shkëlqej e hapësirës ajrore të NATO-s u regjistrua në Rumani. Në fjalimin vjetor për “Gjendjen e Bashkimit”, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, theksoi nevojën për rritjen e mbrojtjes nga dronët, duke shpallur një hua prej 6 miliardë eurosh për t’u bashkuar në një “aleancë dronësh” me Ukrainën. Ajo sugjeroi edhe një nismë të quajtur “Eastern Flank Watch”, që do të ofrojë “mbikëqyrje hapësinore në kohë reale” nga Baltiku deri në Detin e Zi. Von der Leyen u zotua gjithashtu për ndërtimin e një “muri dronësh” - diçka që Komisioni i saj kishte refuzuar ta financonte më herët këtë vit, kur Estonia, Letonia dhe Lituania kërkuar fonde për një projekt të tillë. Hollësitë për këtë nismë mbeten



të paqarta: nuk ka shifra konkrete për buxhetin, as shtrirje gjeografike të saktë, përveç faktit që Komisioni Evropian pritet të paraqesë në tetor një plan të ri për projekte të përbashkëta mbrojtjeje. Po ashtu, Zelensky tha në një intervistë për “Sky News” se nevojitet një “qëndrim i qartë” nga presidenti amerikan Donald Trump për sanksionet ndaj

Rusisë dhe për garancitë e sigurisë për Ukrainën. Ai i bëri thirrje Trumpit, i cili po nis një vizitë zyrtare në Britani, të ndërmarrë “hapa të fortë personalë” për ta “ndaluar Putinin”. “Unë besoj se ShBA është mjaftueshëm e fortë për të marrë vendime të veta. Besoj se Donald Trumpi mund të na ofrojë sisteme mbrojtjeje ajrore në sasi, dhe ShBA ka të

mjaftueshme”, tha Zelensky. “Jam i bindur se ShBA mund të vendosë sanksione të mjaftueshme për ta dëmtuar ekonominë ruse, dhe se Donald Trumpi ka forcën për ta bërë Putinin të ketë frikë prej tij. Evropa tashmë ka miratuar 18 paketa sanksionesh ndaj Rusisë. Ajo që mungon tani është një paketë e fuqishme sanksionesh nga ShBA-ja”.

SI U PRIT NË KOSOVË DËSHMIA E JAMES RUBINIT NË MBROJTJE TË THAÇIT NË HAGË?



PRISHTINË, 16 SHTATOR - Dëshmia e ish-diplomatit të lartë amerikan për mbrojtjen e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën para Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, është parë e rëndësishme dhe vendimtare në favor të mbrojtjes së ish-eprorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

James Rubin, ish-ndihmës i sekretarit amerikan të Shtetit, dëshmitari i parë i mbrojtjes së Thaçit, tha se ai nuk kishte autoritet të plotë mbi komandantët e UÇK -së. "Ishte e qartë për mua se ai nuk ishte në krye. Ai nuk kishte dijeni, aftësinë apo autoritetin për të marrë vendime në asnjë mënyrë", tha Rubini para gjykatës të hënën.

Thaçi po gjykohej në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, së bashku me tre ish-udhëheqës të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit - akuza që ata i kanë mohuar plotësisht.

Rubini, gjithashtu, dëshmoi se nuk kishte asnjë informacion

që e lidh Thaçin ose të akuzuarin tjetër, Jakup Krasniqi, me pretendimet për vrasje apo ekzekutime.

Cilat ishin reagimet?

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, tha për dëshminë e Rubinit se në Hagë "po dëshmon një mik i madh nga përtej Atlantikut". "Kjo është një dëshmi e qartë, e bazuar në fakte të pakontestueshme, për drejtësinë e luftës sonë çlirimtare, për qëllimet e saj dhe përpjekjet e çlirimtarëve tanë për paqe e liri, duke hedhur poshtë të gjitha akuzat e Prokurorisë ndaj tyre", shkroi Krasniqi në "Facebook".

Krasniqi, i cili tani udhëheq partinë të cilën për vite të tëra pas luftës së vitit 1998-'99 e udhëhoqi Thaçi dhe pastaj Veseli, shtoi se "me Shtetet e Bashkuara krah, dhe asses ndryshe, Kosova gjithmonë ka triumfuar mbi padrejtësitë dhe sfidat më të mëdha".

Rubini ka qenë ish-ndihmës sekretar i shtetit për çështjet e informacionit publik dhe zëdhënës kryesor i Madeleine

Albright kur ajo ishte sekretare e shtetit në administratën e Klintonit. Ai ishte me Albrightin në bisedimet e paqes në Francë në vitin 1999 dhe më vonë shërbeu negociator i posaçëm në bisedimet për çarmatosjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Rubini e përshkroi Thaçin para gjykatës si një "figurë politike" pa pushtet të vërtetë.

Analisti politik Agon Maliqi shkroi në "Facebook" se dëshmia e Rubinit "është dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm historik që i përmbys shumë narracione propagandistike". "Ai e çmonton argumentin kryesor të prokurorisë, të cilin e di çdo njeri në Kosovë me sens arsyeje, se UÇK ka pasur strukturë qendrore të konsoliduar apo dhe të aftë për të udhëzuar dhunë dhe krime në mënyrë sistematike", theksoi Maliqi. Sipas tij, dëshmia e ish-diplomatit të lartë amerikan e "jep pasqyrën e një grupi të decentralizuar dhe kaotik që vepron në rrethanat e përballjes me një shtet me plane shfarosëse që u materializuan në Bosnjë - kontekst kyç të cilin

prokuroria e anashkalon krejtësisht, thajse UÇK doli maleve për të kontrolluar territor prej pikës së qejfit".

Ai beson se dëshmia e tij e bazuar në raporte të inteligjencës gjithashtu "nuk mundohet ta mohojë ekzistencën e krimeve sporadike ndaj civilëve, por e konteston idenë se ajo ka qenë e organizuar dhe aludon - saktësisht do të thosha - se ajo ishte më shumë produkt i kaosit dhe mungesës së kontrollit, si dhe e tërheq vërejtjen se ka pasur edhe propagandë të Beogradit". "Është e qartë se krimet e dokumentuara nga prokuroria kanë qenë më shumë qërim lokal hesapësh apo sulme hakmarrëse, dhe se viktimat e tyre meritojnë drejtësi. Por, Prokuroria e Speciales qartazi e ka humbur adresën e kësaj përgjegjësie, duke u munduar ta ndërtojë një akuzë politike, duke prodhuar kështu padrejtësi të dyfishtë", përfundoi Maliqi.

Për drejtorin e Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), Lulëzim Peci, dëshmia e Rubinit si dëshmitar i mbrojtjes të ish-presidentit Thaçi nuk ishte

"vetëm një dëshmi e thjeshtë gjyqësore!" "Kjo dëshmi është edhe një ligjëratë publike e dorës së parë për historinë moderne të Kosovës, leadershipin vizionar të shqiptarëve, luftën e UÇK-se dhe rrugëtimin e saj drejtë pavarësisë!" shkroi Peci në "Facebook".

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, në një postim në "Facebook", tha se ndihet mirënjohëse dhe falënderuese për praninë dhe gatishmërinë e Rubinit për të dëshmuar në Dhomat e Specializuara në Hagë. "Dëshmia e tij e qartë, e drejtë dhe e bazuar në të vërtetën, është një dëshmi tjetër e mbështetjes së vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Kosovën, në veçanti gjatë luftës sonë çlirimtare dhe në mbrojtje të vlerave të UÇK-së", tha ajo.

Gjykimi i katër ish-eprorëve të UÇK-së nisi në vitin 2023.

Thaçi ishte udhëheqës politik i UÇK-së para dhe gjatë luftës së viteve 1998-'99, Veseli ishte udhëheqës i shërbimit të inteligjencës së UÇK-së, Krasniqi ishte zëdhënës, ndërsa Selimi në mesin e shtabit të përgjithshëm.



RUBINI KRITIKON SPECIALEN PËR GJYKIMIN E KRERËVE TË UÇK-së: KJO NUK ËSHTË DREJTËSI, AKUZAT JANË TË PABAZA

Ish-ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, James Rubin, në ditën e dytë të dëshmisë së tij në Dhomat e Specializuara në Hagë, është ballafaquar me pyetjet e prokurorisë dhe me disa deklarata që kishte dhënë më parë rreth këtij procesi gjyqësor dhe aktakuzën ndaj Hashim Thaçit dhe të tjerëve. Ai e quajti të padrejtë mbajtjen për pesë vjet në paraburgim të të akuzuarve, të cilët, sipas tij, u dorëzuan vullnetarisht. Rubini ka thënë se kjo nuk është drejtësi dhe akuzat janë të pabaza. Ai në dëshminë e tij ka pohuar se nuk kishte kontroll dhe komandë efektive në UÇK

Speciale nëse ishte në dijeni për një raport të vitit 1998 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), ku flitej për gjoja rrëmbimin e civilëve serbë, shqiptarë dhe romë, dhe të oficerëve të policisë serbe, nga njerëz që besohej se i përkisnin UÇK-së. “Kam lexuar një raport të OKB-së për Kosovën, por kam qenë shumë skeptik për atë raport”, është shprehur Rubini. “Sepse organet e OKB-së nuk e kanë përshkruar shumë mirë situatën shumë shpesh”, ka thënë ai. “Pra, kam qenë në dijeni të raportimit prej OKB-së, por jo domosdoshmërisht ka qenë i besueshëm raporti”, ka shtuar Rubini. Ai ka thënë se raportet e Kryqit të Kuq i konsideronte më të besueshme. Më herët Rubini pohoi se mund të jetë në dijeni të raporteve nga Departamenti Amerikan i Shtetit, të cilat shkruanin se UÇK-ja ishte përgjegjëse për vrasje, ndalime, rrëmbime edhe të civilëve shqiptarë. Prokurori e pyeti për disa artikuj specifikë në gazetën e asaj kohe për vrasje dhe arrestime të disa individëve. Megjithatë ai shtoi se nuk i kujtohen raste specifike që janë shkruar në raporte apo në mediet ndërkombëtare pas më shumë se 20 vjetësh. I pyetur nëse kishte dëgjuar të thuhej se UÇK-ja po kryente krime, gjatë kohës që Rubini po përcillte konfliktin në Kosovë, ai

tha se nëse do të kishte dëgjuar, do t’i mësonte, por shtoi se “disa gjëra u shfaqën pas luftës”. Ish-zyrtari i lartë amerikan, James Rubin, u pyet në Gjykatën Speciale nëse ishte në dijeni për një raport të vitit 1998 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), ku flitej për gjoja rrëmbimin e civilëve serbë, shqiptarë dhe romë, dhe të oficerëve të policisë serbe, nga njerëz që besohej se i përkisnin UÇK-së. “Kam lexuar një raport të OKB-së për Kosovën, por kam qenë shumë skeptik për atë raport”, është shprehur Rubini. “Sepse, organet e OKB-së nuk e kanë përshkruar shumë mirë situatën shumë shpesh”, ka thënë ai. “Pra, kam qenë në dijeni të raportimit prej OKB-së, por jo domosdoshmërisht ka qenë i besueshëm raporti”, ka shtuar Rubini. Ish-zyrtari amerikan ka thënë se nuk e ka lexuar dosjen paragjyqësore e as aktakuzën e as nuk ka ndjekur dëshmitë e dëshmitarëve të mëparshëm. Prokurori Peace ia përmendi që Rubini kishte thënë se akuzat ndaj Thaçit janë absurde. “Ju thatë në televizion se zoti Thaçi po ndiqet penalisht për arsye krejt absurde. A është kjo ajo që keni thënë?”, pyeti prokurori. “Po, besoj që këtë e kam thënë”, tha James Rubini. Rubini u pyet për një artikull të gazetës “The New York Times”, të

datës 25 qershor 1999, ku thuhej se komandantët e lartë të UÇK-së kanë kryer vrasje brenda radhëve të tyre. Sipas artikullit të lexuar nga prokurori, Hashim Thaçi drejtoi fushatën e vrasjes së disa komandantëve. Akuzat për vrasje ishin bërë nga pjesëtarë të UÇK-së të diplomatëve amerikanë, të cilët, gjoja, thanë se kishin parë me sytë e tyre vrasjen e rivalëve të Thaçit. Rubini tha se nuk i kujtohet ky artikull, por shtoi se ka dyshime për autorin e tij, Chris Hedges. “Autori i këtij artikulli në mënyrë të vazhdueshme ka shkruar fjali që kanë qenë të reme”, tha ai.

Kritikat e Rubinit për Specialet

James Rubini tregoi arsyet pse ai ka refuzuar të jetë dëshmitar i Prokurorisë në rastin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit dhe të tjerëve, duke thënë se kjo ka të bëjë me pikëpamjet e tij për Gjykatën Speciale. Ai e quajti të padrejtë mbajtjen për pesë vjet në paraburgim të të akuzuarve, të cilët, sipas tij, u dorëzuan vullnetarisht. “Janë dorëzuar vullnetarisht dhe kanë bashkëpunuar me Prokurorinë. S’e kuptoj pse kanë qëndruar kaq gjatë në burg. Kjo më shqetëson”, tha ai. Sipas Rubinit, kjo s’ka të bëjë me shtetin e së

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

HAGË, 16 SHTATOR - Në ditën e dytë të dëshmisë së tij në Gjykatën Speciale, James Rubini iu përgjigj pyetjeve të Prokurorisë në lidhje me një dokument ku thuhej se Adem Demaçi përshkruante Hashim Thaçin si zëdhënës të UÇK-së. Rubini tha se nuk kishte informacione për këto dallime të vogla brenda UÇK-së. I pyetur nëse kishte takuar Jakup Krasniqin në kohën e luftës, Rubini tha se nuk mendoi që po, teksa shtoi se nuk i kujtohet nëse Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli ishin pjesë e delegacionit shqiptar në Rambuje. “Nuk më kujtohen të gjithë emrat, sepse kjo ka ndodhur para 25 vjetësh”, tha Rubini. Gjatë dëshmisë së tij, James

Rubini tha se përshtypja fillestare e ShBA-së për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ishte më ndryshe. “Ndoshta ne shkelëm dëshirën tonë që të ishim në anën e engjëjve gjithmonë. Ne fillimisht e përshkruanim si organizatë me aktivitete terroriste dhe ne, sigurisht, me gjithë dëshirën që kishim të ishim në anën e engjëjve, nuk donim të mbështesnim njerëz që zhvillonin aktivitete terroriste. Ky qëndrim ndryshoi, sidomos pasi UÇK-ja u pajtua me Marrëveshjen e Rambujesë”, u shpreh ai. Rubini përsëriti përgjigjen e djeshme se ka pasur shumë pretendime e akuza, për krime lufte nga pjesëtarë të UÇK-së, por se ShBA-ja nuk arriti t’i vërtetonte ato. Ish-zyrtari i lartë amerikan, James Rubin, u pyet në Gjykatën

drejtës dhe, sipas tij, Madeleine Albright nuk ka pasur këtë në mendje kur ka formuar Tribunalin e Hagës për ish-Jugosllavinë. “Kjo ka qenë e gabuar. Kjo nuk është drejtësi”, shtoi ai. “Mua kjo më është dukur si fajësim politik, për shkak se Hashim Thaçi ka qenë udhëheqës i UÇK-së”.

Rubini: Thaçin e konsideronim udhëheqës, e kishin caktuar vetë shqiptarët

James Rubini ka sqaruar edhe njëherë përshtypjet e tij për Hashim Thaçin në periudhën e Konferencës së Rambujesë. Sipas Rubinit, Thaçi ishte personi kyç me të cilin ai duhej të punonte, në mënyrë që Marrëveshja të pranohej nga UÇK-ja. “Ne mendonim se LDK-ja, Veton Surroi, ishin dakord për këtë, dhe ajo [sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright] më tha që duhej të punoja me të [Thaçin], sepse ishte person i rëndësishëm, ishte personi kryesor që e kishin caktuar shqiptarët e Kosovës”, tha Rubini. “Nëse doni e quajmë udhëheqës, nëse doni person të kontaktit”, u shpreh ai. Ai e përshkroi rolin e Thaçit në atë kohë si të një kryediplomati të Kosovës. “Pra, unë atë e kam parë si ministër të Jashtëm, që pasqyronte pikëpamjet e ushtrisë së vet, të qeverisë së vet, që nënshkruante, pra ashtu si një ministër i Punëve të Jashtme”, shtoi Rubini.

Rubini: Nuk kishte kontroll dhe komandë efektive në UÇK

Ish-zyrtari i lartë i ShBA-së, James Rubin, ka folur për

diskutimet në administratën amerikane të Bill Clintonit për armatosjen e UÇK-së. Ai ka thënë se nuk kanë mundur t’u thoshin luftëtarëve që “nuk ju japim armë, sepse ju nuk jeni të organizuar”. “Po bënim një gjykim sa i përket argumentit për armatosjen apo jo të UÇK-së”. “Dhe, ne kemi thënë se kjo nuk është ide e mirë, sipas nesh, sepse nuk ekziston një strukturë e mirëfilltë politike, ose nuk ka kontroll efektiv”. “Bëmë gjykimin tonë më të mirë, kemi bërë një vlerësim, duke marrë parasysh strukturën organizative të UÇK-së, duke marrë parasysh aspektin e kontrollit dhe komandës, që ne besonim që UÇK-ja nuk e kishte”. “Nuk kishte kontroll dhe komandë efektive në UÇK”, theksoi ai.

Rubini: Ky gjykim është i padrejtë, i njoh nga afër liderët e UÇK-së

Ish-diplomati amerikan James Rubin ka deklaruar se gjykimi në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) nuk përbën drejtësi, duke argumentuar këtë qëndrim me faktin se i ka parë nga afër liderët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe veprimet e tyre. “Duke qenë se i kam parë nga afër liderët e UÇK-së në male dhe bjeshkë, mendoj se asnjë person tjetër jashtë UÇK-së nuk ka pasur këtë mundësi. Duke pasur një ide të qartë për funksionimin e UÇK-së, për tri ditë me radhë kam vëzhguar sjelljen e tyre, kush ishte përgjegjës, kush komandant dhe kush mbështetës”, tha ai. Rubini tha para trupit të prokurorisë se ka të drejtë të japë opinion lidhur me procesin që po zhvillohet në Hagë. “Me këtë

Rubini: Clintoni u impresionua nga sjellja e Thaçit gjatë luftës

James Rubini ka deklaruar se ish-presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Bill Clinton, i kishte bërë shumë përshtypje sjellja e Hashim Thaçit. Rubini u shpreh se deklarata e Thaçit, se nuk do të hakmerreshin ndaj Serbisë, ishte ajo që e kishte impresionuar Clintonin. “Presidenti Clinton më tha se i kishte bërë shumë përshtypje fakti që po fliste me udhëheqësin e UÇK-së në një kohë lufte, kur njerëzit

kishin parë vrasje të tmerrshme. Megjithatë, Thaçi, pa u nxituar, i tha presidentit Clinton se mesazhi që donte t’i përcillte botës ishte se, pavarësisht prej dhunës që kishin pësuar, ata nuk do të kundërpërgjigjeshin dhe nuk do të merrnin hak. Sigurisht, në këto rrethana mund të kishte akte dhune, por presidentit Clinton i bëri shumë përshtypje sjellja e Thaçit”, tha Rubini.

njohuri, unë vërtet mendoj se kjo ka qenë e gabuar dhe nuk përbën drejtësi. Nuk jam jurist me profesion, por kam të drejtë të shpreh dhe të them me zë të lartë opinionin tim”.

Ish-ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, James Rubin, u përgjigj me ‘Jo’ në pyetjen se a e di se për çfarë u themelua Gjykata Speciale. Por, Rubini tha se e di se kjo gjykatë u themelua “me kërkesë të liderëve evropianë dhe amerikanë”. Ai shtoi se e di për akuzat e ngritura nga Dick Marty në raportin e tij, ku akuzon Hashim Thaçin për trafikim organesh por, sipas tij, këto akuza nuk përfunduan askund. Më herët Rubini rikonfirmoi disa deklarata të mëhershme të tij për Gjykatën Speciale. “Ka dalë jashtë kontrolli... Krijuan një rast të pabazë. Po e shpikin ligjin...”, ishte shprehur ai. James Rubini ka vazhduar dëshminë e tij, duke iu përgjigjur pyetjeve të trupit gjykues. Një nga gjykatësit e pyeti atë se

nga e dinte që ishte krahu ushtarak i UÇK-së që merrte vendime - pasi Rubini, në ditën e parë të dëshmisë, kishte thënë, duke iu referuar Hashim Thaçit, se “unë kuptova se ai ishte më tepër figura publike e UÇK-së dhe nuk ishte ai në komandë të saj”. Rubini tha se ky ishte perceptimi i tij, këtë e kishte kuptuar vetë, jo se ia kishte thënë Thaçi se të tjerët në UÇK marrin vendime. Rubini u përgjigj edhe për vendndodhjen e Thaçit gjatë bisedave telefonike me të në periudhën e luftës. Sipas tij, Thaçi kryesisht ishte brenda Kosovës kur komunikonin. “Më ka thënë se ishte në Kosovë, duke u fshehur të mos vritej”, tha Rubini. Ai pohoi se pas luftës i ka diskutuar me Hashim Thaçin akuzat për krime lufte gjoja të kryera nga pjesëtarë të UÇK-së kundër serbëve dhe pakicave të tjera, në një takim në Kosovë në fund të pranverës së vitit 1999. Ai tregoi se e kishte

paralajmëruar Thaçin se nuk do ta kishin mbështetjen e ShBA-së nëse do të hakmerreshin për krimet e Serbisë të kryera në Kosovë. “Hashim, ne kemi shkuar në betejë për ty, kemi luftuar për ty, kemi vënë besueshmërinë tonë në rrezik për këtë gjë, dhe ne do të dilnim shumë-shumë keq nëse ju ua bëni tani serbëve atë që ata jua kanë bërë juve në mënyrë të tmerrshme”, kujtoi Rubini t’i ketë thënë Thaçit.

Rubini tha se, për këtë, Thaçi e siguroi se “do të bënte gjithçka që ishte në përgjegjësinë e tij, që kjo të mos ndodhte”. Ai shtoi se Thaçi i bëri me dije se akuzat për krime lufte janë pretendime të rrejshme.

James Rubini e vazhdoi dëshminë e tij duke thënë se Christopher Hilli nuk ishte miqësor me Hashim Thaçin në Rambuje. “E dija se Chris Hill do të jepte shpjegime negative për sjelljen e tij dhe do të bënte komente negative për Thaçin te delegacioni amerikan, dhe mund t’i bënte këto edhe për senatorin Bobe Dole”, tha Rubin. I pyetur nga gjykatësi Christoph Barthe nga Gjermania nëse Thaçi po fshihej kur erdhi koha për ta nënshkruar marrëveshjen, Rubini theksoi: “Qëndrimi nuk do të ishte i shkreti Thaçi është fshehur, por Hill tha ‘pse nuk është këtu ai’, ‘pse bën ai sikur është një person i rëndësishëm’”. “Unë isha në dijeni që Hill kishte ndikim në këtë situatë, dhe do të përpiqesha të thosha se ka arsye që nuk është këtu, ndoshta ka mbetur në bjeshkë, ndoshta është në rrezik”, tha Rubini. Rubini tha se Thaçi i kishte thënë se i duhej të udhëtonte maleve sepse kishte fletarrestim për të nga Serbia në mars 1999. Ai tha se nuk e kishte parë fletarrestimin, por i besonte.



BOTOHET LIBRI I ARSIM BAJRAMIT “KONFERENCA E RAMBUJESË DHE INTERVENIMI I NATO-s NË KOSOVË”

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Ky studim është bërë në 25-vjetorin e mbajtjes së Konferencës së Rambujesë dhe bombardimeve të NATO-s në Kosovë që mundësoi çlirimin dhe më vonë pavarësinë e Kosovës. Duke qenë se Arsim Bajrami ka qenë pjesëmarrës në këtë konferencë, në Rambuje dhe Paris, në cilësinë e këshilltarit ligjor, ka bërë përpjekje të vë në pah prapaskenat e saj dhe kryqëzimin e politikave ndërkombëtare në raport me Kosovën. “Krahas përpjekjes për t’i parandaluar synimet e Serbisë, për të zbatuar gjenocidin e dytë në Kosovë, pas atij në Bosnjë, Konferenca e Rambujesë shënoi fillimin e një rendi të ri botëror, i cili legjitimon përdorimin e forcës së NATO-s, kudo që shkelen të drejtat e njeriut, kryhen krimet kundër njerëzimit, spastrimi etnik dhe politikat e gjenocidit”, ka theksuar autori i këtij libri, akademik Arsim Bajrami. Ai ka thënë se Konferenca e Rambujesë përfaqëson një ngjarje të rëndësishme në procesin e shtetformimit dhe pavarësisë së Kosovës. “Ajo ishte ngjarja e parë historike, në të cilën bashkësia ndërkombëtare, përmes Grupit të Kontaktit, vendosi të kërkojë një zgjidhje për statusin juridik dhe politik të Kosovës. Pas padrejtësive historike të një shekulli më parë, kur në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, më 1913, fuqitë e mëdha copëtuan trojet etnike shqiptare, Konferenca e Rambujesë ishte rasti i parë kur shqiptarët e Kosovës u ftuan në një konferencë për të vendosur për fatin e tyre. Edhe pse kjo konferencë nuk solli menjëherë pavarësinë, falë rezistencës shekullore, luftës heroike të UÇK-së dhe bombardimeve të

NATO-s, drejtësia e mohuar për shekuj u kthye më 17 shkurt 2008, me shpalljen dhe njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës”, ka vlerësuar Bajrami. Konferenca u mbajt nga 6 deri më 23 shkurt 1999 në Rambuje (Rambouillet), Francë, dhe kishte rëndësi të madhe në kontekstin e luftës në Kosovë dhe përpjekjeve për një zgjidhje paqësore. “Ajo ofroi një mundësi për negociata ndërmjet delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë, me synim arritjen e një marrëveshjeje paqësore. Në konferencë morën pjesë ShBA-të, BE-ja, Rusia dhe shtete të tjera të Grupit të Kontaktit, të cilat shprehën mbështetje për një zgjidhje diplomatike”, ka thënë ai. Bajrami ka pohuar se dështimi për të arritur një marrëveshje gjatë konferencës i hapi rrugën ndërhyrjes ushtarake të NATO-s e cila filloi në mars 1999. Ai thotë se kjo ndërhyrje kishte për qëllim ndalimin e krimeve kundër njerëzimit, pastrimit etnik dhe gjenocidit që po ndodhnin ndaj shqiptarëve në Kosovë. Synimi kryesor i Konferencës së Rambujesë ishte ndalja e luftës dhe gjenocidit serb përmes një marrëveshjeje të përkohshme paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Arsim Bajrami ka thënë se Konferenca e Rambujesë ka rëndësi të jashtëzakonshme për tri arsye kryesore: 1. Mundësoi ndërhyrjen ndërkombëtare të NATO-s në një fazë të hershme të luftës - një intervenim parandalues që zgjati 78 ditë dhe e detyroi Serbinë të kapitullojë dhe të pranojë Marrëveshjen e Kumanovës. 2. Mundësoi çlirimin e plotë të Kosovës dhe largimin e forcave militare e paramilitare serbe. 3. Krijoi një partneritet strategjik midis



Perëndimit dhe Kosovës - veçanërisht mes NATO-s dhe UÇK-së, si dhe mes ShBA-së, Britanisë së Madhe, BE-së dhe popullit të Kosovës në rrugën drejt lirisë dhe pavarësisë. “Konferenca e Rambujesë ishte një fitore politike dhe diplomatike për Kosovën dhe bashkësinë ndërkombëtare. Epilogu i saj ishte më i miri i mundshëm për Kosovën: pala kosovare e pranoi marrëveshjen, ndërsa ajo serbe e refuzoi, duke hapur rrugën për fillimin e bombardimeve pa një miratim

formal nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së”, është shprehur ai. Bajrami ka shtuar se “kjo ndërhyrje ka promovuar doktrinën e intervenimit humanitar, duke vendosur një precedent global: askush nuk mund të kryejë gjenocid apo krime kundër njerëzimit pa u ndëshkuar nga bashkësia ndërkombëtare. Ishte kjo hera e parë pas Luftës së Dytë Botërore që u zhvillua një fushatë bombardimesh pa autorizim nga Këshilli i Sigurimit, çka shkaktoi debat në qarqet

juridike. Juristët e ndikuar nga doktrina sovjetike e konsideruan si shkelje të së drejtës ndërkombëtare, ndërsa të tjerë, me qasje pragmatike, argumentuan se ndërhyrja afirmoi dhe reformoi të drejtën ndërkombëtare humanitare, sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së”. “Sot, 25 vjet më pas, mund të themi se Kosova ka qenë me fat që ky intervenim ndodhi në një kontekst të favorshëm gjeopolitik, kur raporti i forcave ndërkombëtare ishte në favor të ShBA-ve, Britanisë së Madhe dhe aleatëve të tjerë perëndimorë. Në situatën aktuale, kur bota po shkon drejt një rendi bipolar, madje edhe tripolar, një ndërhyrje e tillë do të ishte thuajse e pamundur. Duke qenë se ky libër imi është jubilar (i dyzeti me radhë) dhe i kushtohet një ngjarjeje historike, që ndryshoi historinë e Kosovës, në kohën kur populli i Kosovës nëpërmjet UÇK-së zhvillonte luftën ‘për liri, ose vdekje’, këtë botim ia dedikoj nënës sime, Jalldyze Shamolli Bajrami, që ndërroi jetë kur unë po i shkruaja faqet e fundit të këtij libri”. “Së fundi, dëshiroj t’i falënderoj të gjithë ata që më ndihmuan për hartimin dhe botimin e këtij libri, duke filluar nga ASHAK-u, recensentët: akademikët Jusuf Bajraktari dhe Muhamedin Kullashi, redaktoren e këtij botimi, prof. dr. Gjyljeta Mushkolaj, mr. Lirik Veselajn për redaktuarën teknike, lektorin prof. dr. Xhavit Beqirin, stafin teknik të ASHAK-ut, kolegët nga Fakulteti Juridik për kontributin, këshillat dhe sugjerimet e dhëna gjatë hartimit të këtij libri”, ka njoftuar Bajrami.

URAN ISMAILI RRËFEN PËR HERË TË PARË PËR JETËN E VET

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Kandidati i PDK-së për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka ndarë një video emocionale, ku për herë të parë flet hapur për jetën personale, familjen dhe rrugëtimin politik. Në këtë paraqitje emocionale Ismaili kthehet pas te fëmijëria në Bregun e Diellit, vitet e okupimit serb, shkollimin në shtëpi-shkolla dhe momentet e vështira që e formësuan karakterin e tij. “Në moshën 14-vjeçare e kam humbur nënën. Ajo ka qenë shtylla e familjes. Humbja e saj ishte shumë e vështirë, por më forcoi lidhjen me babanë, i cili më mësoi se në



jetë duhet punuar shumë për t’i dalë zot vetes”, rrëfen ai. Ismaili ndalet edhe te jeta familjare që e krijoi, duke

treguar për takimin me bashkëshorten Arizonën, të cilën e quan partneren me të cilën ka ndërtuar çdo gjë, nga

familja me dy fëmijët Omerin dhe Umën, deri te rrugëtimi i tij politik. Për bashkëshorten e tij ai tha se ajo nuk është vetëm dashuria e jetës së tij, po edhe partner i tij në çdo gjë sferë. Ai kujton studimet në Harvard, të cilat i dhanë mesazhin që e mban si udhërrëfyes: politika është për t’i shërbyer vendit dhe njerëzve. Në video një vend të rëndësishëm zë periudha kur ishte ministër i Shëndetësisë, kohë kur thotë se u bënë reforma që shpëtuan jetë dhe kursyen miliona euro të shteti dhe qytetarëve. “I larguam listat e pritjes për stenta dhe e ndalëm

korupsionin me barnat”, kujton ai, duke shtuar se jo vetëm gjatë ushtrimit të këtij funksioni, por përherë ka besuar në ekspertizë dhe jo në ndarje partiake. Në fund të rrëfimit Ismaili i rikthehet garës së vitit 2021 dhe thirrjes së tij të njohur “Hajde ma gjallë, Prishtinë”, duke theksuar se mbështetja e qytetarëve i ka dhënë forcë për të vazhduar edhe këtë herë. “Unë nuk dorëzohem. Prishtina është një për mua. Këtu jetoj e këtu kam me qenë gjithmonë. Është koha për qytetarin e Prishtinës. Është koha për një jetë normale. Sot është koha për Prishtinën”, thotë Ismaili.

Gucati dhe Syla takojnë ambasadoren kroate, ia shprehin shqetësimet për Specialen

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Përfaqësuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Guçati dhe Gazmend Syla, janë takuar me ambasadoren e Kroacisë në Kosovë, Danijela Barišić. Në komunikatën e OVLUÇK-së është thënë se në takim kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me Specialen dhe trajtimin e ish-udhëheqësve të

UÇK-së. “Sot, në vazhden e angazhimeve tona për të adresuar padrejtësitë që po ndodhin në Gjykatën Speciale, zhvilluam një takim me Ambasadoren e Kroacisë në Kosovë, znj. Danijela Barišić. Me respekt dhe vëmendje u dëgjuan shqetësimet tona lidhur me trajtimin e ish-udhëheqësve të UÇK-së, ndërsa u dakorduar që këto

shqetësime të përcillen edhe tek institucionet shtetërore të Kroacisë, si shtet mik dhe partner i rëndësishëm i Kosovës. Gjithashtu shprehëm mirënjohjen tonë për shtetin kroat, i cili në kohët më të vështira qëndroi pranë popullit të Kosovës dhe mbështeti luftën tonë për liri”, është thënë në komunikatën e OVLUÇK-së.



BARDUANI: RRUGA DREJT SIGURISË SË QËNDRUESHME NË KOSOVË NUK ËSHTË USHTARAKE, POR POLITIKE

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Më 15 dhe 16 shtator 2025 komandanti i Forcës së udhëhequr nga NATO në Kosovë (KFOR), gjeneralmajor Enrico Barduani, mbajti raportin përfundimtar të përfundimit të mandatit përpara Komitetit Ushtarak të NATO-s dhe Këshillit të Atlantikut të Veriut, të dyja në formatin e KFOR-it, në selinë e NATO-s në Bruksel.

Gjeneralmajor Barduani ndau vlerësimin e tij për situatën e sigurisë si dhe informacionet më të fundit për aktivitetet e KFOR-it dhe drejtimin e përgjithshëm të misionit. Barduani deklaroi se rruga drejt sigurisë së qëndrueshme në Kosovë nuk është ushtarake, por politike. Ai theksoi se: “Situata në Kosovë është e qëndrueshme, por mbetet subjekt i rreziqeve të përshkallëzimit të papritur për shkak të një sërë çështjesh të pazgjidhura” dhe se, pavarësisht prej sfidave në terren, “KFOR-i ka qëndruar në rrugën e duhur”, duke ndihmuar në “ruajtjen e stabilitetit dhe zbutjen e situatave që mund të kishin çuar në incidente ose shpërthime të paqëndrueshmërisë” dhe duke kontribuar “në ruajtjen e një kuadri sigurie që mund t’i ndihmonte përpjekjet e



vazhdueshme dhe të rëndësishme diplomatike”. Duke theksuar mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s dhe KFOR-it për dialogun e lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, gjeneralmajor Barduani theksoi se “KFOR-i ka treguar edhe një herë se është i gatshëm dhe i

aftë ta luajë rolin e tij dhe ta përshtatë qasjen e tij, sipas nevojës. Megjithatë, rruga drejt një sigurie të qëndrueshme në Kosovë nuk është ushtarake. Ajo është politike”. “Që të lëvizim përpara është e rëndësishme që Beogradi dhe Prishtina t’i zbatojnë marrëveshjet ekzistuese. Të dyja palët duhet të tregojnë

fleksibilitet dhe t’i bëjnë kompromiset e nevojshme”, ka thënë ai. Ai, po ashtu, shprehu vlerësimin mbi situatën e sigurisë në Kosovë, duke theksuar angazhimin e qëndrueshëm dhe të suksesshëm të KFOR-it për stabilitet dhe në mbështetje të veprimeve diplomatike, me fokus të veçantë në dialogun e

lehtësuar nga BE-ja midis Beogradit dhe Prishtinës. Ai theksoi, për arritjeve të KFOR-it, forcimin e misionit edhe përmes vendosjes së përkohshme të forcave rezervë, gjithashtu edhe bashkëpunimin e thelluar me bashkësinë ndërkombëtare, organizatat e sigurisë së Kosovës dhe Forcat e Armatosura Serbe.

OSMANI PRET QË OSBE-ja DO TË VAZHDOJË T’I MBËSHTESË PRIORITETET E KOSOVËS



PRISHTINË, 16 SHTATOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim ministren e Punëve të Jashtme të Finlandës, njëkohësisht kryesuese e OSBE-së, Elina Valtonen. Gjatë takimit presidentja Osmani e falënderoi Finlandën për mbështetjen e vazhdueshme dhënë Republikës së Kosovës,

veçanërisht në proceset e shtetndërtimit, demokratizimit dhe forcimit të institucioneve. Në cilësinë e kryesueses së OSBE-së, Valtonen u informua nga presidentja Osmani mbi zhvillimet e fundit në Kosovë, përkushtimin e institucioneve ndaj paqes dhe stabilitetit si dhe zbatimin e rendit dhe ligjit. Presidentja Osmani ritheksoi

përkushtimin e Kosovës për bashkëpunim të ngushtë me OSBE-në në procesin e reformave, transparencës institucionale dhe të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst, Osmani theksoi se pret që OSBE-ja do të vazhdojë t’i mbështesë prioritetet kyçe të Kosovës, përfshirë barazinë gjinore dhe fuqizimin e të drejtave të njeriut.

PDK-ja të premtën hap fushatën në Skenderaj, Lushtaku: Nisim rrugën drejt fitores së madhe

Skenderaj, 16 shtator - Të premtën, më 19 shtator, nga ora 18:00, në Sheshin “Adem Jashari” në Skenderaj, PDK-ja do ta hapë fushatën zgjedhore.

“Me vizion të qartë, me program të fuqishëm dhe me një ekip të përkushtuar, nisim rrugën drejt zhvillimit dhe fitores së madhe më 12 tetor.

Në këtë rrugëtim vazhdojmë projektet e mira të realizuara deri më tani, por edhe hapim horizonte të reja për të ardhmen e Skenderajt, sepse

qyteti ynë meriton edhe shumë punë dhe projekte të reja”, ka shkruar në “Facebook” kandidati i PDK-së për kryetar të Skenderajt, Sami Lushtaku.



Rafuna: Bizneset po përballen me sfida që s’kanë qenë asnjëherë që 25 vjet

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, tha se bizneset në Kosovë po përballen me sfida si asnjëherë më parë. “Biznesi është duke u përballur me një sfidë si asnjëherë më parë që nga paslufta, sepse ne kemi kaluar në faza të ndryshme të tranzicionit. Edhe kërkesat e biznesit kanë qenë të ndryshme, por kësaj here biznesi është

duke kaluar në sfida shumë, shumë të mëdha”, u shpreh ai, raporton “Betimi për Drejtësi”. Sipas tij, sfidat fillojnë pasi ekzekutivi apo institucionet e vendit nuk kanë marrë asnjë veprim për reforma, duke thënë se është viti i shtatë që nuk ka asnjë reformë në politikat fiskale. Veç kësaj, sfidë tha se është sistemi i arsimit, pasi nuk ka asnjë reformë që e lidh

sistemin e arsimit me reformat e tregut. “Te sundimi i ligjit nuk kemi ende reforma që biznesit i jep mundësi që lëndët të zgjidhen në një afat sa më të shkurtër ashtu siç e kërkon ligji së pari dhe siç ishte dashtë me qenë për të mirën e biznesit”, shtoi ai. Rafuna foli edhe për sfidën e fundit që, sipas tij, është energjia elektrike, si dhe për sjelljen e

investitorëve të huaj, për shkak të, siç thotë ai, deklaratave të pamatura të udhëheqësve të institucioneve. “Po sulmohemi, po bëhet luftë, sanksionet e Bashkimit Evropian, prishja e raporteve me partnerët strategjik dhe gjitha këto jo vetëm që e kanë tremb investitorin e huaj, por edhe investitorët tonë që ta shtrijnë investimin jo në Kosovë, por në



vendet e rajonit. Biznesi është duke u përballë me sfida, po e them edhe një herë që s’kanë qenë në 25 vjet e fundit”, ka thënë Rafuna.

SHAHINI: KOSOVA NË POZITËN MË TË RËNDË QË NGA PASLUFTA

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka reaguuar ndaj zhvillimeve të fundit në raportet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë, duke thënë se sanksionet e Bashkimit Evropian dhe pezullimi i dialogut strategjik me ShBA-në po e vendosin shtetin në pozitën më të rëndë që nga paslufta. Sipas tij, përjashtimi nga nisma e partneritetit strategjik, është ndër masat më serioze që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ndërmarrë ndonjëherë ndaj Kosovës. “Kjo është një nga veprimet më të rënda që Amerika i ka bërë Kosovës”, ka thënë Shahini. Shahini ka paralajmëruar se vendosja e Kosovës në një grup me shtete si Rusia, Kina dhe



Gjeorgjia, të cilat janë përjashtuar nga dialogu strategjik, ka pasoja të mëdha për imazhin ndërkombëtar të vendit.

Duke folur për zhvillimet e fundit, ai ka thënë se pezullimi i dialogut me ShBA-në e vendos Kosovën në pozitë të krahasueshme me vendet që

konsiderohen agresore ndaj demokracisë. “Kosova po perceptohet njëjtë si Rusia pas agresionit në Ukrainë”, ka thënë ai, duke shtuar se vendi rrezikon të shihet si kërcënim ndaj demokracisë perëndimore dhe asaj të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ndër të tjera, ai ka thënë se kjo gjendje rrezikon në masë të madhe rënien e investimeve të huaja dhe dëmtimin e rëndë të imazhit politik, ekonomik dhe diplomatik të Kosovës. Lideri i AKB-së ka kritikuar qeverisjen e brendshme dhe ngërçin institucional që, sipas tij, ka ndikuar në thellimin e krizës. “Është e pakuptimtë që institucionet janë jashtë funksionit tash e një vit dhe merren me fushatë”, ka thënë ai,

duke shtuar se “nuk shihet fundi i ndërtimit të institucioneve”. Ai ka thënë se mesazhi i ShBA-së është i qartë ku, sipas tij, të njëjtit kërkojnë ndryshim qasjeje, veçanërisht nga kryeministri Albin Kurti. “ShBA-ja merr veprime të ngjashme kundër liderit të një shteti, në këtë rast Albin Kurtit, e qe më këtë dëshirojnë t’u dërgojnë mesazh votuesve që ta ndryshojnë mendjen, edhe vetë liderit të ndryshojë qasjen ndaj votuesve, ndaj partnerëve vendorë e ndërkombëtarë”, ka thënë ai. Shahini ka paralajmëruar se, nëse kjo situatë vazhdon, rënia e investimeve të huaja dhe dëmtimi i besimit ndërkombëtar do të kenë pasoja të pashmangshme. /GazetaBlic/

ZKA-JA: FONDI PËR BURIMET E RIPËRTËRISHME TË ENERGJISË NUK U MENAXHUA NË MËNYRË EFIKASE

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit “Menaxhimi i Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë” për periudhën 2017-2024. Raporti vlerësoi efikasitetin e menaxhimit të këtij fondi nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregu (KOSTT) si dhe mbikëqyrjen nga Ministria e Ekonomisë (ME) për zbatimin e masave për burimet e ripërtërishme të energjisë. “Rezultatet e auditimit tregojnë se Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) nuk kishte arritur të menaxhojë Fondin në mënyrë efikase. Janë identifikuar mangësi gjatë fazës testuese të prodhueseve të burimeve të ripërtërishme të energjisë, në procesin e organizimit të shitblerjes së energjisë së ripërtërishme si dhe në

realizimin e të hyrave për Fondin”, ka njoftuar ZKA-ja. Sipas këtij njoftimi, Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk ka kryer monitorimin efektiv të Fondit, po ashtu Ministria e Ekonomisë nuk ka bërë monitorim të mjaftueshëm të zbatimit të politikave të burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe arritjen e caqeve të vendosur para vitit 2020. ZKA-ja ka theksuar se auditimi ka evidentuar mangësi gjatë fazës testuese dhe certifikimit të prodhueseve të energjisë së ripërtërishme nga KOSTT. “Nuk ishin siguruar garancitë financiare për furnizuesit dhe as për prodhuesit e burimeve të ripërtërishme të energjisë. Në procesin e shitblerjes së kësaj energjie është identifikuar nivel i lartë i jo balancave, gjithashtu nuk kishte mekanizma efektiv



për minimizimin e këtyre jo balancave të cilat shkaktojnë

kosto shtesë për Fondin. KOSTT nuk ishte efikas në inkasimin e

të hyrave në Fond. Inkasimet nga furnizuesit kishin vonesa deri në 7 muaj dhe vlera totale e obligimeve ishte 20 milionë euro”, ka njoftuar ZKA-ja. Lidhur me këtë auditim, auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, ka theksuar se institucionet përgjegjëse nuk ishin efikase për arritjen e caqeve të vendosura për vitin 2020 për burimet e ripërtërishme të energjisë (era, dielli dhe uji). Po ashtu, skemat mbështetëse të hartuara për këtë qëllim nuk kanë arritur të ndihmojnë në përbushjen e këtyre caqeve. Me qëllim të rritjes së efikasitetit në menaxhimin dhe funksionimin e Fondit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë nëntë rekomandime.

Nderohen me pulla postare atdhetarët Musa Shehzade dhe Metush Krasniqi

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Posta e Kosovës, përmes Filatelistë, ka lëshuar të martën në qarkullim emisionin e pullave postare

“Personalitete - Musa Shehzade dhe Metush Krasniqi. Dy kohë, një qëllim - Lirinë e Atdheut”. Bëhet me dije se ky emision i

pullave postare nderon dy figura që zënë vend të veçantë në historinë shqiptare, të cilët, edhe pse vepruan në kohë të

ndryshme, kontribuan për të njëjtin qëllim: lirinë e vendit dhe respektimin e të drejtave të popullit shqiptar.



“NUK DUA QË EVROPA TË BLEJË NAFTË RUSE”

Trump rrit presionin mbi Evropën për naftën ruse: “Jam gati për sanksione të reja”

Presidenti amerikan Donald Trump ka rikthyer në qendër të debatit çështjen e energjisë dhe marrëdhënieve mes Perëndimit dhe Rusisë. Në një mesazh të publikuar në platformën e tij Truth Social, ai akuzoi vendet evropiane anëtare të NATO-s se po “dobësojnë fuqinë e tyre negociuese” duke vijuar të blejnë naftë nga Moska.

“Evropa është duke blerë naftë nga Rusia. Nuk dua që ta blejnë... dhe sanksionet që po vendosin nuk janë mjaftueshëm të forta”, u shpreh Trump, duke theksuar se është i gatshëm të ndërmarrë sanksione të reja ndaj Moskës nëse vendet e NATO-s bien dakord të bëjnë të njëjtën gjë.

Një letër për NATO-n

Presidenti amerikan e quajti mesazhin e tij “një letër për vendet e NATO-s”, ku theksonte: “Jam gati të veproj sapo të thoni ju. Vetëm më thoni kur.” Ai u shpreh i habitur që shtete evropiane vijnë të blejnë naftë

ruse, duke e quajtur këtë praktikë “shokuese”. Sipas tij, kjo dëmton strategjinë e Perëndimit dhe i jep Moskës burimin kryesor të financimit për luftën në Ukrainë.

Presion mbi Evropën, por edhe mbi Kinën

Trump ka sugjeruar që vendet e NATO-s të vendosin tarifa nga 50 deri në 100% mbi importet nga Kina, me qëllim që të dobësojnë ndikimin e Pekinit mbi Rusinë. Edhe pse administrata e tij nuk ka zbatuar ende tarifa të reja ndaj Kinës për shkak të blerjeve të naftës ruse, retorika e tij synon të lidhë direkt tri qendra të mëdha gjeopolitike: SHBA, Evropën dhe Kinën.

India në shënjestër

Krahas Evropës, India është vendosur nën presion të fortë. Para dy javësh, Trump vendosi 25% tarifa shtesë ndaj mallrave indiane, duke e çuar totalin në



50%, për shkak të vijimit të importit të naftës ruse. New Delhi, nga ana e vet, e justifikon këtë politikë si nevojë për sigurinë energjetike dhe çmime të përballueshme, jo si aleancë politike. Qeveria e Modi-t ka akuzuar Perëndimin për “standarde të dyfishta”, duke

kujtuar se edhe vendet evropiane vazhdojnë tregtinë me Rusinë në fusha të tjera.

Një ekuilibër delikat

Megjithëse retorika e Trump është e fortë, shumë analistë paralajmërojnë për pasojat e

mundshme të kufizimeve të reja energjetike. Tregu botëror i naftës mund të përballet me rritje të çmimeve, që në fund do të dëmtonte edhe konsumatorët perëndimorë. Në fakt, që nga pushtimi i Ukrainës në shkurt 2022, varësia e Evropës nga nafta ruse ka rënë ndjeshëm, por ende nuk është eliminuar plotësisht.

Trump i ka dhënë disa herë Moskës afat dyjavor për të ndryshuar kursin, afate që Kremlin i ka injoruar. Ndërkohë, ministrat e financave të G7 diskutuan javën e kaluar opsione të reja për sanksione, përfshirë edhe tarifa ndaj vendeve që konsiderohen si “mundësues” të luftës ruse. Në këtë skakierë ku nafta është kthyer në armë politike, SHBA po përpiqet të mbajë në një front të bashkuar NATO-n dhe partnerët globalë. Por retorika e ashpër e Trumpit, kombinimi i kërcënimeve me tarifa dhe pritshmërive të larta nga aleatët, e bën edhe më të vështirë gjetjen e një kompromisi të qëndrueshëm. / bota.al

ÇFARË NDODHI ME 7 MREKULLITË E BOTËS SË LASHTË?


Shtatë Mrekullitë e Botës së Lashtë ishin një koleksion strukturash të admiruara nga shkrimtarët dhe udhëtarët grekë si arritje të bukurisë dhe inxhinierisë njerëzore. Autorë antikë si Diodori i Sicilisë dhe Antipatri i Sidonit hartuan lista të këtyre “pamjeve për t’u parë”, por lista që ne përdorim sot u përforcua gjatë Rilindjes, kur vetëm njëra nga mrekullitë ishte ende në këmbë.

1. Piramida e Madhe e Gizës (Egjipt)

Piramida e Madhe është e vetmja mrekulli e lashtë ende ekzistuese. E ndërtuar në shek. XXV p.e.s. gjatë dinastisë së IV-të, ajo ishte varri monumental i faraonit Khufu (Cheops). Më pas u ngritën edhe dy piramida nga i biri Khafre dhe nipi Menkaure. Fillimisht shkëlqenin me gurë gëlqerorë të bardhë dhe majë prej ari, por grabitjet dhe koha i zhveshën. Edhe pse të plaçkitura herët, ato mbeten simbol i fuqisë faraonike.

2. Mauzoleumi i Halikarnasit (Turqi e sotme)

Ndërtuar në shek. IV p.e.s. për mbretin Mausol dhe motrën-



bashkëshorten Artemisia II, ishte 45 metra i lartë dhe i zbukuruar me mbi 400 skulptura. Përshkruhej nga autorë si Plini dhe Straboni si një kryevepër arti. Ende qëndronte në kohën romake, por u rrënuara para vitit 1402, kur kalorësit kryqtarë përdorën gurët e tij për të ndërtuar kështjellën e Bodrumit.

3. Tempulli i Artemisit në Efes (Turqi e sotme)

I dedikuar perëndeshës Artemis, ishte ndërtuar tre herë. I pari u shkatërrua nga përmbytja në shek. VII p.e.s., i

dyti u dogj nga Herostrati në 356 p.e.s., në natën e lindjes së Aleksandrit të Madh, dhe i treti u ngrit më vonë në shek. IV p.e.s. Ky tempull madhështor u shkatërrua nga sulmet gotike dhe më vonë u rrëzua nga të krishterët. Sot në vendin e tij qëndron vetëm një kolonë e rindërtuar nga copëzat e gjetura.

4. Statuja e Zeusit në Olimp (Greqi)

E krijuar nga Fidias i në shek. V p.e.s., statuja ishte 14 metra e lartë, prej druri e veshur me fletë ari e fildishi. Ishte imazhi më i

famshëm i Zeusit. U qëndroi shekujve, por me mbylljen e tempujve paganë në shek. IV, fati i saj u bë i paqartë. Me shumë gjasa u shkatërrua nga zjarri pas rënies së tempullit. Legjendat thonë se u transferua në Kostandinopojë, por nuk ka prova.

5. Gjiganti i Rodit (Greqi)

Një statujë prej bronzi 33 metra e lartë e perëndisë Helios, e ngritur në vitet 280 p.e.s. për të festuar fitoren ndaj Demetrit Poliorketi. Zgjatë vetëm 54 vjet: një tërmet i vitit 226 p.e.s. e rrëzoi. Banorët e Rodit e panë si shenjë të zemërimit hyjnor dhe nuk e rindërtuan. Shtrirë përtokë, mbeti një spektakël për shekuj, por në fund fragmentet u shkrinë ose u plaçkitën.

6. Fari i Aleksandrisë (Egjipt)

I ndërtuar në ishullin Faros gjatë sundimit të Ptolemeut II, rreth 100 metra i lartë, ishte fari më i famshëm i lashtësisë. Shërbeu për shekuj si udhërrëfyes për portin e Aleksandrisë. U dëmtua rëndë nga tërmete në shek. X, XIV dhe XV, derisa u shkatërrua plotësisht. Në 1480, gurët e tij u përdorën për të ndërtuar Kalatën Qaitbay. Sot fragmente të tij qëndrojnë nën ujë.

7. Kopshtet e varura të Babilonisë

Mrekullia më misterioze, ndoshta as që ekzistoi. Thuhet se u ndërtuan nga Nabukodonosori II në shek. VII p.e.s., me terraca të gjelbëruara dhe sisteme ujitjeje të sofistikuara. Por nuk ka burime të drejtpërdrejta që i përmendin, as tekste babilonase dhe as gjurmë arkeologjike në Babiloninë e sotme. Disa mendojnë se ishin në Nineveh, ndërtuar nga mbreti asirian Sennakerib. Në çdo rast, fati i tyre u tret bashkë me rënien e qytetit.

Fati i 7 Mrekullive

Koha i përul të gjitha gjërat. Është paradoksale që më e vjetra — Piramida e Gizës — është e vetmja që mbijeton. Ideja për të ruajtur monumente thjesht si trashëgimi historike është e re; për njerëzit e lashtë, ndërtesat humbnin funksionin dhe braktiseshin. Ashtu si kështjellat britanike të rrënuara, rrënojat e mbuluara me bimësi të Çiçen Icës, apo mbetjet e fundosura të Farit të Aleksandrisë, edhe mrekullitë e lashta iu dorëzuan kohës dhe natyrës. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

DUKA: SHQIPËRIA DO TË LUAJË ME SERBINË NË LESKOVAC, VENDIMI PËR SYLVINHON NË VARËSI TË KUALIFIKIMIT

TIRANË, 16 SHTATOR - Në një intervistë për emisionin “Opinion” në “TV Klan”, presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF), Armand Duka, ka folur për sfidën e tetorit kundër Serbisë dhe për të ardhmen e Kombëtares. Duka ka sqaruar se vendimi për vendin e zhvillimit të ndeshjes do të merret nga FIFA. Fillimisht Serbia kishte caktuar stadiumin e Crvena Zvezdës në Beograd, por faktorët politikë dhe pasojat nga ndeshja me Anglinë e detyruan Federatën serbe ta ndryshonte vendin e takimit. Ndeshja do të

zhvillohet në stadiumin e Leskovacit, që ka 8 mijë vende dhe do të ofrojë një kontroll më të mirë organizativ. Duka ka theksuar se, për shkak të raporteve të tensionuara, nuk do të ketë tifozë serbë në Shqipëri dhe as tifozë shqiptarë në Serbi. Kombëtarja shqiptare do të udhëtojë për në Leskovac më 10 tetor, për të vazhduar me ndeshjen miqësore kundër Jordanisë më pas. Presidenti i FShF-së ka folur edhe për formën e ekipit, duke theksuar se është ende herët për të nxjerrë konkluzione për futbollistët, pasi ndeshja me Gjibraltarin ishte një miqësore.

Sa i përket trajnerit Sylvinho, Duka ka lënë të hapur mundësinë e një ndryshimi nëse Shqipëria nuk arrin të kualifikohet për Botërorin 2026. Për ndeshjen miqësore me Jordaninë, Duka ka shpjeguar se ekipet evropiane ishin të zëna dhe për këtë arsye u zgjodh një kundërshtar jashtë Evropës, që është gjithashtu një kundërshtar i denjë. Kjo ndeshje me Serbinë pritet të ketë rëndësi të madhe për klasifikimin në Botërorin 2026, duke e bërë të domosdoshëm çdo rezultat të mirë nga Kombëtarja shqiptare.



PAQARADA LËNDOHET RËNDË, KËPUT LIGAMENTIN



Heidenheim, 16 shtator - Një debutim për t'u harruar për Leart Paqaradën, pasi mbrojtësi i majtë i Kosovës ka pësuar një lëndim të rëndë në ndeshjen e tij të parë me Heidenheimin kundër Borussia Dortmundit. Vetëm pas shtatë minutash lojë ai u detyrua ta linte fushën, ndërsa skuadra e tij pësoi humbjen 2-0 në shtëpi dhe mbetet pa pikë në fund të tabelës së Bundesligës. Kontrollët mjekësore kanë konfirmuar lajmin e keq:

Paqarada ka këputur ligamentin kryqëzor të gjurit të majtë dhe në ditët e ardhshme do t'i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale. Rikuperimi pritet të zgjasë disa muaj, duke e lënë jashtë fushe për një periudhë të gjatë. Trajneri i Heidenheimit, Frank Schmidt, nuk e ka fshehur zhgënjimin pas lëndimit të mbrojtësit që u bashkua këtë afat kalimtar. “Ky është një lajm i rëndë për të gjithë, por mbi të gjitha për Leartin vetë. I urojmë shërim të suksesshëm

dhe do ta mbështesim në çdo hap. Ne duhet të qëndrojmë më afër si ekip dhe ta kompensojmë mungesën e tij me përgjegjësi kolektive”, ka thënë ai. 30-vjeçari i është bashkuar Heidenheimit këtë verë nga Kolni dhe ka kontratë me klubin gjerman deri më 30 qershor 2027. Ky lëndim e ndërpret brutalisht nisjen e aventurës së tij të re, ndërsa ai përgatitej të sillte përvojën dhe lidërshpin e tij në skuadrën debutuese të Bundesligës.

MILANI DHE INTERI ARRIJNË MARRËVESHJE PËR BLERJEN E SAN SIROS

MILAN, 16 SHTATOR - Kryebashkiaku i Milanos, Beppe Sala, ka konfirmuar të martën se Milani dhe Interi kanë rënë dakord ta blejnë zonën e San Siros, përfshirë stadiumin Giuseppe Meazza. “Gjithçka është në rregull. Të mërkurën duhet të shkojmë në këshill me rezolutën për



shitjen e San Siros sepse, në fakt, kemi arritur një marrëveshje me klubet”, ka thënë fillimisht Sala për “RTL 102.5”. Ai ka thënë se stadiumi i ri duhet të jetë gati deri në vitin 2031 sepse, sipas tij, “UEFA po na thotë se nuk do ta marrin në konsideratë Milanon për

Kampionatin Evropian 2032 nëse San Siro mbetet”. “Do të ketë një rezolutë dhe një propozim për projektin. Meqenëse po flasim për transferimin e aseteve kaq të rëndësishme, kjo do të kalojë më pas në Këshillin e Qytetit. Së pari do të ketë komisione dhe diskutime, pastaj duhet të arrijmë në një vendim, qoftë

po ose jo. Dua të kem ndërgjegje të pastër. Do ta sjell rezolutën në këshill dhe do ta mbështes miratimin e tij. Do të votoj për dhe më pas do t'i takojë Këshillit Bashkiak të vendosë. E gjithë kjo do të ndodhë deri në fund të muajit”, ka thënë i pari i bashkisë së Milanos.

Lewandowski drejt largimit, Laporta rikthen “ëndrrën” e madhe

BARCELONË, 16 SHTATOR - Presidenti i FC Barcelona, Joan Laporta, është duke menduar seriozisht për transferimin e Erling Haaland në verën e vitit 2026, sipas raportimeve nga “El Nacional”. Lëvizja lidhet me largimin e Robert Lewandowskit, që nuk do ta

rinovojë kontratën dhe pritet të përfundojë në Arabinë Saudite. Haaland, i shndërruar tashmë në një nga sulmuesit më frikësues në Evropë te Manchester City, është konsideruar prej kohësh nga Laporta si zëvendësuesi ideal për qendrën e sulmit të

Barcelonës. Megjithatë çmimi i transferimit dhe paga e lojtarit mund të kalojnë 150 milionë euro, Laporta beson se ndikimi sportiv dhe medial do ta justifikojë investimin. Në moshën 26-vjeçare Haaland do të bëhej forca kryesore e sulmit, duke kompletuar talentet e reja si

Lamine Yamal dhe Pedri për të formuar një treshe sulmuese që mund të dominojë në Evropë. Kjo lëvizje konsiderohet rrezik strategjik, por Laporta mbetet i bindur: për ta rikthyer Barcelonën në majat e futbollit, Haalandi është një domosdoshmëri.



Edon Zhegrova pritet të debutojë me Juventusin në ndeshjen e Ligës së Kampionëve kundër Dortmundit

Ylli i ri i Juventusit, Edon Zhegrova, mund të debutojë për Bianconerët sonte (e martë), pasi u përfshi në skuadër për ndeshjen hapëse të Ligës së

Kampionëve kundër Borussia Dortmund. Zonja e Vjetër është nikoqire e gjermanëve në ndeshjen e xhiros së parë të fazës së Ligës së

Kampionëve 2025/26, me takimin që pritet të zhvillohet në "Allianz Stadium" nga ora 21:00. Në këtë ndeshje pritet të debutojë edhe ylli kosovar,

Zhegrova, i cili ka qenë jashtë fushave që nga janari dhe fillimisht u njoftua se do të humbiste ndeshjen e mesjavës në garat evropiane.



TENTATIVA PËR TË KORRUPTUAR TOPIN E ARTË, PASTAJ JUSTIFIKIMI ABSURD: "FAJI I NJË PRAKTIKANTI"

Një skandal klasik nuk shpërtheu, por pothuajse ndodhi kur Neal Gardner, një nga gazetarët që përfaqësonin Australinë duke votuar për Topin e Artë 2025, publikoi atë që dukej të ishte një përpjekje e vërtetë për korrupsion në favor të Ousmane Dembele, sulmuesi i PSG-së i konsideruar si pasardhësi i denjë i Rodri-t. Ndërsa votimi u mbyll, Gardner mori një email të çuditshëm nga një agjenci mediatike indiane e paidentifikuar. Pasi u zbulua, e gjithë çështja u sqarua me një justifikim pothuajse surreal: "Një iniciativë spontane e dërguar nga një praktikant i ri, një student i apasionuar pas futbollit". Përmbajtja e emailit nuk lë vend për dyshime për qëllimin e tij përfundimtar: "Ne po planifikojmë një fushatë për të stimuluar dialogun dhe për të forcuar narrativën përreth kandidaturës së Ousmane Dembele për Topin e Artë", thuhet në deklaratë. "Në mënyrë specifike, ne do të donim të ofronim tre postime në rrjetet sociale të hartuara me

kujdes në javë për një muaj, duke nxjerrë në pah performancat e tij, ndikimin e tij dhe argumentet që mbështesin vlerësimin e tij. "Duke pasur parasysh besueshmërinë dhe ndikimin tuaj brenda komunitetit të futbollit, pjesëmarrja juaj do t'i shtonte peshë të konsiderueshme kësaj bisede. Në këtë pikë, ne do të donim të kërkonim një ofertë për këtë bashkëpunim". Sigurisht, u nisën hetime dhe kontrolle, dhe shpejt u vërtetua se kjo kompani fantazmë – e quajtur me sa duket Bangrr International, me seli në Indi dhe e themeluar nga Ali Husain, e cila synon të bëhet "një fuqi e gjeneratës së ardhshme në marketing, reklamim dhe përmbajtje, duke ripërcaktuar rrëfimin e markave luksoze", nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me Ousmane Dembele, i cili menjëherë konfirmoi pafajësinë e tij të plotë në incident. Sigurisht, përballë protestës mediatike rreth ankesës së Gardner, në një përpjekje për të



shpjeguar se çfarë kishte ndodhur vërtet dhe për të zhdukur hijet e dyshimit, CEO i kompanisë, Ali Husain, deklaroi: "Ky email ishte një iniciativë spontane e dërguar nga një praktikant i ri në agjencinë tonë. Një student i apasionuar pas futbollit, reklamimit dhe krijimit të përmbajtjes dixhitale, praktikanti kishte vënë re

mesazhin e fundit të Z. Gardner që fliste për kërkesa për bashkëpunim. "Kjo e frymëzoi atë të kryente kërkime personale mbi mënyrën se si influencuesit dhe gazetarët strukturojnë partneritetet e tyre me markat, veçanërisht në industrinë e futbollit", tha Ali Husain për mediat amerikane. "Praktikanti e pa këtë si një

mundësi për të mësuar rreth një segmenti tjetër të peizazhit dixhital. Më pas dërgoi një mesazh spekulativ për të pyetur rreth tarifave standarde të industrisë. "Kjo ishte një iniciativë e izoluar, e motivuar nga kurioziteti arsimor, jo një direktivë nga agjencia jonë apo një fushatë e porositur nga një palë e tretë".

NGA SHITËS TELEFONASH NË FITUES TË MEDALJES SË ARTË – CORDELL TINCH TRIUMFON NË 110 METRA ME PENGESA NË TOKIO



Cordell Tinch fitoi medaljen e artë në vrapimin 110 metra me pengesa për meshkuj në Kampionatin Botëror të Atletikës 2025 në Tokio të Japonisë, sot (e martë) më 16 shtator. 25-vjeçari e përfundoi garën për 12.99 sekonda për të fituar një finale emocionuese. Pas amerikanit, ishte Orlando Bennett që mori medaljen e argjendtë me kohë 13.08

sekonda dhe bashkëkombësi i tij Tyler Mason që siguroi medaljen e bronzit me kohë 13.12 sekonda. Fitorja e Tinchit e pa atë gjithashtu të thyente mbretërimin gjashtëvjeçar të Grant Holloway, i cili fitoi tre titujt e fundit botërorë, por nuk arriti të kualifikohej për garën për medaljen e artë pasi doli i gjashti në gjysmëfinale.

Ndryshe, gjatë pushimit trevjeçar nga atletika, Tinch ishte një shitës i telefonave, instalonte kablllo dhe operonte me makineri që prodhonin letra higjienike. "Nuk mendoja se do të arrija këtu pa e bërë shpërndarjen nga atletika, gjatë të cilës e gjeta veten. Të gjej veten ishte gjëja më e rëndësishme në gjithë këtë", ka thënë Tinch.

Ndërron jetë kampionia 23-vjeçare Julia Marie Gaiser

Atletja e patinazhit artistik, Julia Marie Gaiser ka humbur jetën në një aksident tragjik në Salzburg, Austri, pasi u përplas nga një kamion në një kryqëzim. Ekipet e emergjencës tentuan ta rikthenin në jetë, por 23-vjeçarja ndërroi jetë në vendngjarje. Autoritetet kanë hapur një hetim dhe

shoferi i kamionit rezultoi negativ për alkool. Kryebashkiaku i Salzburgut, Andreas Jungmann, shprehu ngushëllime për familjen dhe e cilësoi humbjen si një tronditje të madhe për botën e sportit. Fansat reagues me mesazhe ngushëllimi në rrjetet sociale. Gaiser përfaqësoi më parë

Italinë, para se të kalonte në ekipin e Austrisë dhe të bëhej pjesë e 'Eis Team Salzburg', me të cilin fitoi tre tituj radhazi në 2023, 2024 dhe 2025. Ajo filloi patinazhin në moshën tetë vjeçare dhe gjatë karrierës së shkurtër u vlerësua për pasionin dhe arritjet e saj mbi akull.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte


RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arti Kabashi shpall të pavlefshme dëftesat e shfmu “Fehmi Agani” Gjakovë nga kl.1-5.
 - Qëndrim Hoxha shpall të pavlefshme diplomën e shm mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
 - Vlora Morina shpall të pavlefshme diplomën e sh mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
 - Fitim Duraku shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 si dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
 - Krist Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të shm teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
 - Ajnishahe Haziraj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu “Dëshmorët e Dushkajes” Bardhaniq Gjakovë nga kl. 1-9.
 - Sabahate Qurdina shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë ose “Hysni Zajmi”.
 - Nikoll Gjinaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Engjëll Gjoni” Novosell e Ulët Gjakovë.
 - Cyma Shuti shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu “Shaban Gola” Lipovec Gjakovë nga kl. 1-8.
 - Rozvita Deda shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë drejtimi Farmaci. Berneta Boshnuaku shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
 - Fazli Alija shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu “Dëshmorët e Dushkajes” Bardhaniq Gjakovë nga kl. 1-8.
 - Mërgim Alija shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu “Dëshmorët e Dushkajes” Bardhaniq Gjakovë nga kl. 1-8.
 - Adriatik Kokalla shpall të pavlefshme dëftesat e kl 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
 - “Zivinarska Farma Pilke” shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 811814848.
 - Marigona Bahtiri shpall te pavlefshme diplomën me nr. 71 drejtimi Inxhinieri Ekonomike – Master Fakulteti “Isa Boletini” arsyeja ndërrim mbiemri.
 - Llabinot Murati shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shmle “Hasan Prishtina.
 - Sabit Beqiri shpall te pavlefshme diplomën e shmle “Hasan Prishtina”.
 - Sanije Ibrahimimi shpall te pavlefshme diplomën e shmle “Arkitekt Sinani” ish shkolla “Boris Kidric”.
 - Rinor Xhemajli shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.
 - Edin Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “28 Nëntori” Brodosan.
 - “Burim Toast” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811919466 Prishtinë.
 - Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
 - Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
 - Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
 - Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
 - Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
 - Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
 - Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

